



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:255287

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05569989

**PS.nr.20/24**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL**, kryetari i trupit gjykues Mentor Bajraktari, me bashkëpunëtorin profesional Nazif Fetahu, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Gj M nga Istogu, për shkak të veprës penale Dhënia Ryshfeti në vazhdimësi nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>, veprës penale Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Mashtrimi me Subvencione në vazhdimësi nga neni 324 par.3 lidhur par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së si dhe ndaj të akuzuarit H B nga Ferizaj, për shkak të veprës penale: Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të Kodit penal të Republikës së Kosovës dhe veprës penale Mashtrimi me Subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës<sup>2</sup> me numër PPS.nr.89/2023, të datës 22.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 12.02.2024 dhe mbajtjes së seancës për caktimin e dënimit **me datë 13.03.2024** në prezencën e Prokurorit të shtetit nga PSRK, të akuzuarve si dhe mbrojtësve të tyre, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 12.04.2024 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit:

**1. GJ M**, nga i ati ..., e ëma ..., me mbiemër të vajzërisë ..., i lindur me datë ... në Pejë, tani me vendbanim në fshatin ..., Komuna Istogut, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon si ..., i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ...

**2. H B**, nga i ati ..., e ëma ..., me mbiemër të vajzërisë ..., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna Ferizaj ku edhe tani jeton, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesëm, punon si ..., i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:..

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK-së), nr.06/L-074, i datës 14.01.2019, i cili ka hyrë në fuqi më 19.04.2019.

<sup>2</sup> Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, (Në tekstin e mëtejme PSRK-së).

## JANË FAJTOR

### 1. I akuzuari GJ M

**I.** Në periudhën nga 25.08.2020 deri 02.02.2021 në Istog, i akuzuari **Gj M** në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme i jep para ryshfet të akuzuarit H M që në cilësinë e personit zyrtar, si Zyrtar për Zhvillimin e Bujqësisë në Drejtorinë për Bujqësi në Komunën e Istogut të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare, si në vijim;

*I/1.* Në periudhën nga 25.08.2020 deri me 15.02.2021, derisa i akuzuari **Gj M**, me qëllim të përfitimit të subvencionit aplikon me Kërkesë nr.10/152813 datë 25.08.2020 duke përdorur të dhënat personale të familjarit E M, i akuzuari H M si person zyrtarë pranon dokumentacionin dhe gjatë kontrollit paraqet vërejtje se aplikimi është bërë në mënyrë të kundërligjshëm me të dhëna të pasakta dhe njofton Gj M se nuk mund të përfiton subvencion, mirëpo për ta rregulluar këtë çështje i kërkon ryshfet, pastaj pranohet dokumentacioni dhe në bazë të Vendimit nr. 07/04/2-002795/2020, datë 19.10.2020, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë i aprovon pagesat, pastaj Gj M pranon parat e subvencionit dhe i dorëzon ryshfet në vlerë 4000 Euro të akuzuarit H M në dyqanin e tij, pastaj kur aprovohet pjesa e dytë e subvencionit në bazë të Vendimit nr. 07/04/2-004790/2021, datë 02.02.2021, pasi Gj M i pranon parat ia dorëzon pjesën e dytë të ryshfetit në vlerë 4000 Euro të akuzuarit H M në dyqanin e tij të bletarisë në Istog;

*I/2.* Në periudhën 25.08.2020 deri me 15.02.2021, derisa i akuzuari **Gj M** me qëllim të përfitimit të subvencionit aplikon me Kërkesë nr.10/152815 datë 25.08.2020, duke përdorur të dhënat personale të familjarit L M, i akuzuari H M si person zyrtarë pranon dokumentacionin dhe gjatë kontrollit paraqet vërejtje se aplikimi është bërë në mënyrë të kundërligjshëm me të dhëna të pasakta dhe njofton Gj M se nuk mund të përfiton subvencion, mirëpo për ta rregulluar këtë çështje i kërkon ryshfet në vlerë 7000 Euro dhe Gj M pajtohet me këtë kërkesë, pastaj pranohet dokumentacioni dhe në bazë të Vendimit nr.07/04/2-002792/2020, të datës 19.10.2020 dhe Vendimi nr.07/04/2-004806/2021, të datës 02.02.2021 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë i aprovon pagesat, pastaj Gj M pranon parat e subvencionit dhe i dorëzon ryshfet në vlerë 7000 Euro të akuzuarit H M në dyqanin e tij të bletarisë në Istog;

*I/3.* Me datë 25.08.2020, në Komunën e Istogut, derisa i akuzuari **Gj M** kishte përgatitur dokumentacionin për të aplikuar në mënyrë të rregullt me të dhënat personale të L M, i akuzuari H M i kërkon që të ndryshon kërkesat në formular për aplikim duke plotësuar të dhëna të pasakta dhe në këmbim kërkon që t'i jepet ryshfet në vlerë 7000 Euro, pastaj Gj M së bashku me H M në Kërkesë nr.10/152808, datë 25.08.2020, paraqesin të dhëna të pasakta kinse ka kulturë Bimë Mjekësore dhe Aromatike dhe në bazë të këtij deklarami përfiton subvencion në bazë të Vendimin nr. 07/04/2-045888/2020, datë 18.12.2020 në vlerë 7,537.50 Euro, të cilat këstin e parë e merr Gj M për veti, pastaj Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me Vendim nr. 07/04/2-004766/2021, nuk aprovon tërësisht pagesën për pjesën e dytë dhe nuk realizohet tërësisht marrëveshja për marrjen e ryshfetit;

*I/4.* Me datë 06.10.2020, në fshatin Gurrakoc, Komuna Istog, i akuzuari **Gj M** në mënyrë të drejtpërdrejtë i jep para ryshfet të akuzuarit M N që në cilësinë e personit zyrtar si Inspektor

teknik të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare, në atë mënyrë që derisa i akuzuari M N dhe B G ishin duke kryer kontrollin në lëndën nr.10/152815 në emër të L M, gjejnë se nuk përputhet gjendja faktike me të dhënat në aplikim sepse prona e paraqitur në aplikacion kishte qenë pronë e komunës së Istogut në sipërfaqe prej 15ha, për këtë derisa i akuzuari Bajram Gashi qëndronte në veturë, i akuzuari M N kërkon dhe pranon nga Gj M ryshfet 500 €uro, pastaj hartojnë rrejshëm raportin nr.06/01 datë 06.10.2020, kinse gjendja është në rregull;

**I/5.** Me datë 06.10.2020, në fshatin Gurrakoc, Komuna Istog, i akuzuari **Gj M** në mënyrë të drejtpërdrejtë i jep para ryshfet të akuzuarit M N që në cilësinë e personit zyrtar, si Inspektor në teren të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare, në atë mënyrë që derisa i akuzuari M N dhe B G ishin duke kryer kontrollin në lëndën sipas aplikimit nr.10/152813 në emër të E M, gjejnë se nuk përputhet gjendja faktike me të dhënat në aplikim sepse prona e paraqitur në aplikacion kishte qenë pronë e komunës së Istogut në sipërfaqe prej 22ha dhe kooperativës së Dubravës në sipërfaqe 20ha, për këtë derisa i akuzuari Bajram Gashi qëndronte në veturë, i akuzuari M N kërkon dhe pranon nga Gj M ryshfet 500 €uro, pastaj hartojnë rrejshëm raportin nr.06/02 datë 06.10.2020, kinse gjendja është në rregull;

**I/6.** Me datë 06.12.2020, në fshatin Gurrakoc, Komuna Istog, i akuzuari **Gj M** në mënyrë të drejtpërdrejtë i jep para ryshfet të akuzuarit L H që në cilësinë e personit zyrtar, si Inspektor për kontroll në teren të veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare, në atë mënyrë që derisa i akuzuari L H dhe B M ishin duke kryer kontrollin në lëndën nr.10/152808, në emër të L M, gjejnë se nuk përputhet gjendja faktike me të dhënat në aplikim, për këtë i akuzuari L H dhe B M hartojnë rrejshëm raportin nr.06/138 datë 06.12.2020, kinse gjendja është në rregull duke shtuar numrin e shoqërive të bletëve dhe për këtë shkojnë në kafiterin "Beti" dhe nga Gj M pranojnë ryshfet 500 €uro, ku nga kjo shumë i akuzuari L H dhe B M secili i ndajnë nga 250 €uro.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale: Dhënia e Ryshfetit në vazhdimësi nga neni 422 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së<sup>3</sup>.**

**II.** Në periudhën 19.10.2020 deri 15.02.2021, në Komunën e Istogut, i akuzuari **Gj M** në mënyrë të drejtpërdrejtë i jep përfitim pasuror të akuzuarit H M që të ndikojë te zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimi e Bujqësisë, në atë mënyrë që derisa i akuzuari Gj M kishte aplikuar për subvencione në bazë të Kërkesës nr.10/151772, datë 25.08.2020, në mënyrë të rregullt duke paraqitur të dhëna të sakta, por për këtë çështje i kërkon të akuzuarit H M që të ndikojë të merret vendim që parat e subvencioneve të aprovohen, por i akuzuari H M për këtë i kërkon 2000 €uro, pastaj pasi që aprovohen pagesat sipas Vendimit Ref.AZHB.07/4/2-013187/2020, datë 22.10.2020 dhe Vendimit Ref.AZHB.07/4/2- 004828/2021, datë 02.02.2021, Gj M i jep përfitim të akuzuarit H M në vlerë 2000 €uro në dyqanin e tij në Istog.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale: Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së<sup>4</sup>.**

<sup>3</sup> Sipas pikës 10 të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.89/23, të datës 22.11.2023.

<sup>4</sup> Sipas pikës 11 të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.89/23, të datës 22.11.2023.

**III.** Në periudhën nga 21.08.2020 deri me datë 02.02.2021, i akuzuari **Gj M** me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme në mënyrë të vazhdueshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pa sakta në komunën e Istogut, ashtu që duke përdorur të dhënat personale të familjarëve L M, E M dhe L M aplikon për të përfituar subvencion nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si në vijim;

**III/1.** Me datë 25.08.2020, i akuzuari **Gj M** me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke përdorur të dhënat personale të familjarit E M aplikon në Komunën e Istogut në bazë të Kërkesës nr.10/152813 datë 25.08.2020 duke paraqitur të dhëna të pasakta, duke paraqitur prone e komunës së Istogut në sipërfaqe prej 22ha dhe kooperativës së Dubravës në sipërfaqe 20ha dhe nga këto veprime përfiton subvencione në mënyrë të kundërligjshëm në vlerë 12,600 Euro, andaj me këto veprime i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë 12,600 Euro;

**III/2.** Me datë 25.08.2020, i akuzuari **Gj M** me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshëm ka bërë mashtrim me subvencione duke përdorur të dhënat personale të familjarit L M aplikon në Komunën e Istogut në bazë të Kërkesës nr.10/152815 datë 25.08.2020 duke paraqitur të dhëna të pasakta, duke paraqitur në aplikim prone e komunës së Istogut në sipërfaqe prej 15ha, pastaj i akuzuari Gj M në bazë të këtij deklarami të rreme përfiton subvencion në mënyrë të kundërligjshëm në vlerë 4,500 Euro, me këto veprime i akuzuari Gj M i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerës prej 4,500 Euro;

**III/3.** Me datë 25.08.2020, i akuzuari **Gj M** me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshëm ka bërë mashtrim me subvencione duke përdorur të dhënat personale të familjarit L M aplikon në Komunën e Istogut në bazë të Kërkesës nr. 10/152808 datë 25.08.2020 duke paraqitur të dhëna të pasakta, duke paraqitur gjendje në aplikim me shume se sa që kishte në realitet dhe atë duke shtuar kinse ka kulture Bime Mjekësore he Aromatike 13.5 hektar dhe 90 koshere bletësh dhe me këtë deklarami të rreme përfiton në bazë të Vendimin nr. 07 / 04/ 2-045888/2020, datë 18.12.2020 në vlerë 7.537.50 Euro dhe Vendimin nr. 07 / 04/2-004766 / 2021 në vlerë 1.350 Euro duke përfituar në mënyrë të kundërligjshme në vlerë të përgjithshme 8.887.50 Euro, me këto veprime i akuzuari i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerë prej 8.887.50 Euro.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale Mashtrim me Subvencione në vazhdimësi nga neni 324 par.3 lidhur par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së<sup>5</sup>.**

## **2. I akuzuari H B**

**IV.** Në periudhën nga 03.02.2021 deri 10.02.2021, në Lipjan, i akuzuarit **H B** me qëllim të përfitimit të subvencioneve në mënyrë të kundërligjshme në mënyrë të tërthortë përmes të akuzuarit P K i jap ryshfet të pandehurve L Si dhe B N, që në cilësinë e personave zyrtar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë të veprojnë në kundërshtim me detyrën zyrtare, në atë mënyrë që i akuzuari H B dhe P K paraprakisht arrijnë marrëveshje që të aplikojnë në mënyrë të

<sup>5</sup> Sipas pikës 12 të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.89/23, të datës 22.11.2023.

kundërligjshme me të dhëna të pasakta në bazë të kërkesës nr.17/153956, datë 27.08.2020 për përfitim të subvencioneve në emër të Sh K në komunën e Lipjanit dhe përfitimi të ndahet përgjysmë, paraprakisht H B i jep P K shumën 500€ për të iu dhëne ryshfet inspektorëve, pastaj pasi që aprovohen pagesat në bazë të Vendimit 07/4/2-002729/2020 datë 19.10.2020, P K i tërheq 7,000 Euro nga llogaria bankare e Sh K dhe ia dorëzon 6000 Euro H B dhe 1000 Euro i ndal për veti, pastaj për pjesën e dytë të subvencioneve në bazë të Vendimit 07/4/2-013635/2021 datë 03.02.2021, i akuzuari P K me 03.02.2021 rreth orës 13:00 në Prishtinë, i dërgon ryshfet të akuzuarit B N shumën 5,000 Euro, pastaj në të njëjtën ditë në ora 14:33 B N shkon në zyre te i akuzuari L S dhe shumën e ryshfetit prej 5,000 Euro e ndajnë secili nga 2500 Euro, pastaj për pjesën tjetër me datë 09.02.2021, në ora 18:39 në Fushë Kosovë, i akuzuari B N pranon ryshfet nga P K shumën 2,000 Euro të banesa e tij dhe të nesërmen me datë 10.02.2021 në ora 08:15 i akuzuari B N shkon në zyre te i akuzuari L S dhe shumën e ryshfetit prej 2,000 Euro e ndajnë përgjysmë secili nga 1000 Euro.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale: Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së<sup>6</sup>.**

V. Me datë 27.08.2020, në komunën e Lipjanit, i akuzuari **H B** me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ka bërë mashtrim me subvencione duke paraqitur të dhëna të pa sakta në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në atë mënyrë që paraprakisht arrin marrëveshje me Pajtim Krasniqin që duke përdorur dokumentacionin e familjarit Sh K të aplikojnë për përfitimin e subvencioneve në bazë të kërkesës nr.17/153956, datë 27.08.2020, në komunën e Lipjanit, ashtu që në kërkesë paraqet dokumentacion të personave të ndryshëm nga komuna e Lipjanit dhe Ferizajit duke falsifikuar nënshkrimet, ndërsa digjitalizojnë sipërfaqe të pronës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në sipërfaqe 49.20ha dhe në bazë të këtyre deklarimeve të rreme përfiton subvencion në bazë të vendimit 07/4/2-002729/2020, datë 19.10.2020 dhe vendimit 07/04/2-013635/2021 datë 03.02.2021, me këto veprime i akuzuari H B i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerë gjithsejtë 14.160 Euro.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale Mashtrimi me subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së<sup>7</sup>.**

**Konform nenit 76 par.1 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarve për veprat penale të lartpërmendura fillimisht ia shpallë dënimet për secilën vepër penale veç e veç si në vijim:**

### **1.Të akuzuarit Gj M:**

- Për veprën penale **Dhënia Ryshfetit në vazhdim nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë Dënimin me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, si dhe Dënim me Gjobë në shumë prej tremijë (3000) Euro.**

<sup>6</sup> Sipas pikës 9 të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.89/23, të datës 22.11.2023.

<sup>7</sup> Sipas pikës 13 të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.89/23, të datës 22.11.2023.

- Për veprën penale **Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë Dënimin me Burgim në kohëzgjatje dhjetë (10) muajve si dhe Dënim me Gjobë në shumë prej njëmijë (1000) Euro**
- Për veprën penale **Mashtrimi me Subvencione në vazhdimësi nga neni 324 par.3 lidhur par.1 e lidhur me nenin 77 KPRK-së**, të përshkruar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.**

## **2. Të akuzuarit H B,**

- Për veprën penale **Dhënia e Ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve dhe Dënimin me gjobë në shumë prej tremijë (3000) Euro.**
- Për veprën penale **Mashtrim me subvencione nga neni 324 paragrafi 1 të KPRK-së**, të përshkruar si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **ia shpallë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve.**

**Andaj**, Gjykata në kuptim të neneve 2, 4, 6, 7, 17 par.1, 38, 42, 43, 69, 70, 76 par.2 nënpar.2.2 dhe 2.4, 77, 79, dhe neneve 324 par.1 dhe par.3, 422 par.2, 424 par.2 si dhe neneve 364, dhe 450 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si dhe nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të akuzuarit i:

## **G J Y K O N**

### **1. Të akuzuarin GJ M,**

**ME DËNIM UNIK ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej dy (2) vite e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 03.12.2021 deri datën 24.02.2022 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 25.02.2022 deri më datën 03.05.2022.

**ME DËNIM UNIK ME GJOBË**, në shumë prej katërmijë (4.000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **2. Të akuzuarin H B**

**ME DËNIM UNIK ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 03.12.2021 deri me datën 03.03.2022 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 04.03.2022 deri më datën 03.05.2022.

**ME DËNIM ME GJOBË**, në shumë prej tremijë (3.000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit e lartpërmendur, nuk dëshirojnë ose nuk mundën ti paguajnë dënimet me gjobë, atëherë të akuzuarve dënimet me gjobë i'u zëvendësohen secilit veç e veç me dënim me burgim, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga njëzet (20) Euro, ashtu që:

**1.** Të akuzuarit **Gj M**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dyqind (200) ditëve.

**2.** Të akuzuarit **H B**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindpesëdhjetë (150) ditëve.

**DETYROHEN të akuzuarit e lartpërmendur** që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej njëqind (100) Euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej njëqind (100) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**E dëmtuara** Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

## **A r s y e t i m**

### *1.Ecuria e procedurës penale*

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate me datën 22.11.2023, ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.89/23, të datës 22.11.2023, H M nga Istogu, për shkak të veprave penale: Marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, Ushtrimi i ndikimit në vazhdimësi nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit L S nga Podujeva, për shkak të veprave penale: Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfeti në bashkëkryerje nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 te KPRK-së, ndaj të akuzuarit S Sh nga Kamenica, për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit B N nga Glllogoci, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Marrja e Ryshfetit nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, L H nga Peja, për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 421 par.2 të KPRK-së, M N nga fshati Nivokaz, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Marrja ryshfeti në vazhdimësi nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit B G nga Peja, për shkak të veprës penale Mashtrimi në detyrë nga neni 419 par.1 lidhur me par. 3 dhe me nenin 77 të KPRK - së, P K nga Lipjani, për shkak të veprës penale Ndhimë për veprën penale Marrja e Ryshfetit nga neni 421 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarit **Gj M** nga Istogu, për shkak të veprave penale: Dhënia ryshfeti në vazhdimësi nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së dhe Mashtrimi me Subvencione në vazhdimësi nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,

si dhe ndaj të akuzuarit **H B** nga Ferizaj, për shkak të veprave penale: Dhënia ryshfeti nga neni 422 par.2 të KPRK-së dhe Mashtrimi me Subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit nga PSRK me datë 12.02.2024, pranë kësaj gjykate ka dorëzuar një parashtrësë me të cilën ka bërë plotësimin e aktakuzës, respektivisht precizimin e dëmit të shkaktuar dhe atë në pikat 12.1, 12.2, 12.3 dhe pikën 13 të aktakuzës e që në këtë aktgjykim janë pikat III/1, III/2, III/3 që kanë të bëjnë me të akuzuarin Gj M dhe në pikën V që ka të bëjë me të akuzuarin H B.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2024, në të cilën seancë kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës – Rafet Halimi, të akuzuarit me mbrojtësit e tyre.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës – Rafet Halimi, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari **Gj M**, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: ndjehet fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës për shkak se nuk kam mundur të marr subvencione as grande asnjëherë dhe i pranoj veprimet e ndërmarra si në aktakuzës.

I akuzuari **H B** gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: pranon fajësinë për veprat penale i ngarkohen me akuzës dhe se ndjehet i penduar për veprimet e ndërmarra.

Ndërsa të akuzuarit tjerë të përshkruar me lartë, gjatë shqyrtimit fillestar nuk e kanë pranuar fajësinë lidhur me veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë.

#### 1.1 Mendimi i Prokurorit të shtetit dhe mbrojtësve lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit

Prokurori i shtetit i PSKR-së – Rafet Halimi, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve Gj M dhe H B dhe i propozoj gjykatës që më rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të ketë parasysh si rrethana lehtësuese se i njëjti është fermer dhe nga provat e paraqitura në akuzë shihet se iniciativa për këto veprime ka qenë nga zyrtaret e AZHB duke i kërkuar të njëjtit ryshfet po ashtu edhe për të pandehurin H B pranojmë pranimin e fajësisë dhe propozoj që më rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat renduese dhe lehtësuese ku si rrethane renduese të merr parasysh vlerën e lartë të dhënies së ryshfetit ndërsa si rrethanë lehtësuese se i njëjti është fermer dhe po ashtu iniciativa për dhënie të ryshfetit ka filluar nga zyrtarët e AZHB.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj M, av.Kujtim Kërveshi, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se: ne jemi konsultuar mjaftueshëm me klientin tim edhe gjatë fazës së hetimit, kemi qenë dakord edhe për një arritje të marrëveshjes së pranimin të fajësisë, e kam mirëkuptuar e mirëkuptoj edhe sot prokurorin për shkak të volumit të lëndës që për çështjen e subvencioneve nuk zhvillohet vetëm kjo çështje nuk kemi lidh marrëveshje, jam konsultuar me klientin edhe për saktësinë e precizimit të bërë nga prokurori lidhur me akuzën, i mbrojturi im



pranimin e fajësisë e bën me vullnetin e tij të lirë, duke qene se pranimi i fajësisë se nuk na lejon që të elaboroje prova por besoj që gjykata do ti këtë parasysh dhe besojmë që do ti vlerësoje që ka pasur edhe prova publike në media deri ne vitin 2018 që për fenomene të kundërligjshme me subvencione i mbrojturi im është deklaruar ne TV ne emisionin “Bujku” në RTK. Ashtu siç ju tha edhe juve ashtu siç e kam kuptuar gjate gjithë hetimit edhe unë si mbrojtës, i mbrojturi im ka qene i shtyre për te hyre ne veprime inkriminuese sepse ndryshe nuk do të përfitonte asnjë subvencion. Është e qartë përshkrimi i bërë në akuzë është i saktë andaj edhe i mbrojturi im e pranon sot fajësinë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H B av.Admir Salihu lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: i mbrojturi im pas konsultimit që kemi pasur kemi qenë të gatshëm që të hyjmë edhe në marrëveshje me prokurorin, mirëpo për arsye të lendes së madhe që ka qenë ka qenë e pa mundur marrëveshja andaj konsiderojmë se pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e tij të lire dhe është i informuar për rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në kohën kur është bere aplikimi ka qenë e lejuar edhe që të njëjtat dokumentacion të kërkohet subvencion ne te gjitha komunat dhe intenca e tij ka qene që te marr një subvencion në tokat që punon, përveç që është detyrua me dhënë mito për subvencionin e parë, për aplikimin e dytë ka qenë që të aplikojë për të tjerët me kusht që të përfitojë subvencionin e parë, pra edhe një subvencion të tërë nuk e kanë lejuar, edhe pse kjo nuk e liron nga përgjegjësia se dhënia ryshfetit përben vepër penale mirëpo konsideroj se në shkresat e lendes është evidente dëmi material sa ky ka mundur ti shkaktoj Republikës se Kosovës dhe shuma prej 5000 Euro që ky ka pranuar është realizuar në tërësi lidhur me kërkesat që kanë qen ene subvencion. Pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore ashtu siç e ka paraqitur prokurori në akuze dhe konsideroj se gjykata gjatë marrjes se vendimit për dënim do ti këtë parasysh edhe rrethanat tjera faktike që kanë ardhur deri tek veprimet e të akuzuarit.

## 2. Vlerësimi dhe vendimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale për të cilën janë ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuarve, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tyre, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Vendimi lidhur me veçimin e procedurës

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues, sipas detyrës zyrtare konfrom nenit 35 par.1 të KPP-së, pasi që të akuzuarit Gj M dhe H B kanë pranuar fajësinë për veprat penale si në aktakuzë dhe me qëllimin që të vazhdohet seanca për shqiptimin e dënimit ka marr aktvendim për veçimin e procedurës penale ndaj të njëjtëve me qëllim të efikasitetit të procedurës në raport me të akuzuarit tjerë, ashtu që është vendosur që të veçohet procedura penale ndaj të akuzuarit Gj M për shkak të veprave penale Dhënie ryshfeti nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të

KPRK-së, Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me nenin 1 dhe nenin 77 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuari H B për shkak të veprës penale Dhënie ryshfeti nga neni 422 par.2 të KPRK-së dhe Mashtrim me Subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-se, nga të akuzuarit tjerë të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me numër PPS.nr. 89/2023, të datës 22.11.2023.

#### 4. Shpallja e aktgjykimit dhe caktimi i seancës për dënimin

Gjykata shpalljen e aktgjykimit ndaj të akuzuarve Gj M dhe H B, e kishte caktuar mbajtur me datën 16.02.2024, ashtu që njëjtit i kishe shpallur fajtor për veprat penale për të janë ngarkuar me aktakuzë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare në shpallje të aktgjykimit konform nenit 356 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 të KPP-së kishte caktuar seancën për caktimin e dënimit për datën 13.03.2024 në ora 09:30/h, me qëllim të marrjes së informacioneve shtesë lidhur me llojin dhe caktimin e lartësisë së dënimit dhe po ashtu kishte vendosur që ndaj tyre të kërkohet një raport para ndëshkimor nga Shërbimi Sprovues i Kosovës konform nenit 356 par.6 të KPP-së, ashtu që kishte lëshuar urdhëresat për përgatitjen e raportit para ndëshkues për Drejtorinë Rajonale në Pejë dhe në Ferizaj, përkatësisht në vendbanimin që kishin të akuzuarit.

Gjykata, me datë 06.03.2024 nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, përkatësisht Drejtoria Rajonale në Ferizaj, ka pranuar raportin para ndëshkues me nr.22245/2024-0087 të datës 04.03.2024 për të akuzuarin H B, me të cilën raport kishin nxjerrur konkluzionin se nga informatat që kishin poseduar dhe kontaktet që kanë realizuar me të akuzuarin mendojnë dhe vlerësojnë që ndaj të akuzuarit H B të shqiptohet Dënim Alternativ *“Urdhër për punë në dobi të përgjithshme, apo dënim me kusht”*.

Po ashtu, Gjykata me datën 07.03.2024 nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, përkatësisht Drejtoria Rajonale në Pejë, ka pranuar raportin para ndëshkues me nr.22249/24-0078 të datës 04.03.2024 për të akuzuarin Gj M, me të cilën raport kishin dhënë mendim për zgjedhjen e masës apo dënimit ashtu që duke i marrë për bazë të gjitha konkluzionet kanë dhënë mendim që të njëjtit ti shqiptohet një dënim alternativ që do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin dhe risocializimin e tij në shoqëri.

#### 5. Seanca për caktimin e dënimit

Gjykata konform nenit 365 par.7 të KPP-së, me datë 16.03.2024 ka mbajtur seancën për caktimin e dënimit në të cilën seancën kanë prezantuar: Prokurori Special Rafet Halimi, i akuzuari Gj M së bashku me mbrojtësin e tij av.Etnik Maloku sipas autorizimit zëvendësues për av.Kujtim Kerveshi sipas autorizimit, i akuzuari H B së bashku me mbrojtësin e tij av. Admir Salihu. Prezentë po ashtu janë edhe zyrtaret nga Shërbimi Sprovues – Drejtoria Rajonale në Pejë Ardita Lubeniqi Haxhiaj dhe nga Shërbimi Sprovues – Drejtoria Rajonale Ferizaj – Florije Rexhepi, të cilat zyrtare sprorvuese i kishin hartuar raportet para ndëshkues për të akuzuarit.

Në seancën për caktimin e dënimit fillimisht janë deklaruar zyrtarët e Shërbimeve Sprovuese lidhure me raportet para ndëshkimore të përgatitura për të akuzuarit:

Zyrtarja nga Shërbimin Sprovues – Drejtoria Rajonale në Pejë – A L H, gjatë seancës për caktimin e dënimit sa i përket raportit para ndëshkimit për të akuzuarin Gj M ka deklaruar se: qëndrojnë në tërësi pranë raportit para ndëshkimit dhe nuk kam çka të shtojë me tepër se çka është shënuar në këtë raport para ndëshkimit

Zyrtarja nga Shërbimin Sprovues – Drejtoria Rajonale në Ferizaj F R, gjatë seancës për caktimin e dënimit sa i përket raportit para ndëshkimit për të akuzuarin H B ka deklaruar se: të gjitha informacionet i kemi paraqit në raportin para ndëshkimit gjithashtu edhe sa i përket të kaluarës kriminale ne kemi paraqit edhe raportin e informatave personale të policisë rajonale në Ferizaj si dhe kemi marrë për bazë raportin nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan sa ka qëndruar për 2 muaj lidhur me këtë rast. Sa i përket konkluzionit që kemi paraqit në raport kemi propozuar që të akuzuarit të shqiptohet një dënim alternativ Urdhër në dobi të përgjithshme apo dënim me kusht, ne kemi menduar që këto mundësi të ipen të akuzuarit duke e pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë është penduar thellë për veprimin e tij dhe është betuar që në të ardhmen do të jete me i kujdesshmen me i vëmendshëm dhe gabime të tilla nuk do të përsërisë asnjëherë më. Gjithashtu i akuzuari ka qene edhe 3 muaj në paraburgim dhe 2 muaj në arrest shtëpiak. Është mbajtës dhe përgjegjës i familjes dhe kemi pasur parasysh pasi që ai merret me bujqësi dhe ka investuar shumë dhe gjithë ai investim do të shkojë në dem nëse gjykata parash të shqiptoj dënim tjetër dhe kështu në fund propozojmë që gjykata të vlerësojë këtë rekomandim vetëm si propozim.

Prokurori i shtetit nga PSRK – Rafet Halimi, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se: sa i përket të akuzuarit Gj M prokuroria speciale ka pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Sa i përket rrethanave lehtësuese të akuzuarit Gj M që nga fillimi i procedurës penale ka qenë bashkëpunues si në polici po ashtu edhe në prokurori, dhe që nga fillimi ka pranuar kryerjen e veprës penale të njëjti është mbajtës i familjes dhe po ashtu i akuzuari Gj M ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me prokurorin e shtetit dhe gëzon statusin e Dëshmitarit Bashkëpunues. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese si rrethanë rënduese prokuroria ka pasur parasysh vlerën e lartë të ryshfetit që i është dhënë zyrtareve po ashtu vlera e lartë e përfitimit në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa sa i përket të akuzuarit H B, po ashtu i njëjti si rrethanë lehtësuese prokuroria paraqet se i akuzuari që nga fillimi i procedurës penale ka qenë bashkëpunues në organet e zbatimit të ligjit dhe që nga dita e parë ka pranuar kryerjen e veprës penale po ashtu i njëjti është mbajtës i familjes, ndërsa ka pasur parasysh edhe si rrethanë rënduese vlerën e lartë të ryshfetit dhe vlerën e lartë të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme. Këto janë rrethanat që kemi pasur parasysh me rastin e caktimit të llojit të dënimit

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj M av. Etnik Maloku, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se: mbrojtja e të akuzuarit Gj M pranë gjykatës paraqitet me propozim që gjykata matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit të bëjë konform dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së në atë mënyrë që të merr parasysh rrethanat lehtësuese siç është fakti se i mbrojturi im qysh në fazat e hershme të procedurës penale ka treguar gatishmëri për pranimin e fajësisë me ç'rast jo vetëm që ka

pranuar fajësinë po ka treguar gatishmëri edhe në bashkëpunim vullnetar në cilësi të Dëshmitarit Bashkëpunues me Prokurorin e Shtetit. I mbrojturi Gj, pranimin e fajësisë e ka bërë edhe në seancë fillestare me datë 12.02.2024 pranë kësaj gjykate me ç'rast ka shpreh keqardhje të lartë, pendesë dhe ndjesi të lartë të fajit për veprimet inkriminuese që i ka ndërmarrë. Mbrojtja i propozon gjykatës që vazhdimisht të këtë parasysh faktin se i mbrojturi Gj në vazhdimësi ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë dhe të merr parasysh moshën e tij, faktin që është mbajtës i familjes mbajtjen financiare të familjes e realizon përmes ushtrimit të veprimtarisë së bujkut me ç'rast që vet kjo veprimtari ka qenë arsyeja se pse Gj ka ndërmarrë veprime inkriminuese vetëm me qëllim të sigurimit të ekzistencës së tij familjare. Si rrethanë lehtësuese me peshë, mbrojtja konsideron dhe faktin se i mbrojturi Gj ka hyrë në një marrëveshje formale me prokurorin me qëllim të deklarimit të tij në drejtim të zbardhjes së të vërtetës në këtë procedurë penale në raport me të pandehurit e tjerë. Duke marrë parasysh se i mbrojturi im ka pranuar fajësinë dhe ka cilësinë e Dëshmitarit Bashkëpunues, gjykatës i propozojmë që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ta aplikoj nenin 71 par.1 pika 1.1 dhe 1.3 të KPRK-së ashtu që të zbusë dënimin në raport me kontributin e të mbrojturit tim në bashkëpunim me drejtësinë. Si dëshmi shtesë i cili i konfirmon këto rrethana lehtësuese është raporti para ndëshkues i përpiluar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, si dhe vet deklarimi i prokurorit në këtë seance. Andaj, si përfundim mbrojtja konsideron se edhe në një dënim me të ulët se minimumi i posaçëm i veprave penale do të arrihet qëllimi i dënimit e që është rehabilitimi e jo ndëshkimi.

I akuzuari Gj M, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se: e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit H B Av. Admir Salihu në seancën për caktimin e dënimit ka deklaruar se fillimisht mbështesim raportin para ndëshkues konsiderojmë që raporti në mënyrë të qartë ka përcaktuar kontributin dhe rekomandimi i tij do të ishte i pranueshëm për mua dhe të mbrojturin tim. Ndonëse shpesh herë në dëgjojmë fjalën që pendohemi për kryerjen e veprës penale në rastin konkret pendimi i të mbrojturit tim është real dhe i vërtetë dhe jo vetëm si veprim por i njëjti edhe pasojat e atij pendimi dhe veprimi është duke i paguar edhe në aspektin financiar por edhe në aspektin emocional dhe moral. Ndonëse i njëjti është shpallë fajtor edhe për veprën penale Mashtrim me subvencione dhe Dhënie ryshfeti, realisht i njëjti si bujk ka qenë target i zyrtareve shtetëror që janë marrë me çështjet e subvencioneve. Ndonëse ka qenë target por ka vepruar i njëjti tani po e paguan faturën për gjithë atë çështje. Ndonëse nga prokurori u tha se shkalla e lartë rënduese është vlera e lartë e ryshfetit, ne kemi dëgjuar edhe në seancën e pranimit fillestar ku parimisht nga 14 mijë euro sa ka qenë vlera e atij subvencioni, i mbrojturi im i ka pranuar vetëm 5 mijë euro në rastin e parë ka paguar 2 mijë euro ryshfet, mirëpo në rastin e dyte zyrtarët fare nuk ja kanë dhënë hiq e kanë josh që ky të aplikojë ndërkohë nuk ja kanë dhënë. Megjithatë pranimi i fajësisë po lidhet me pendimin dhe pranimin e pasojave. Nuk është aspak kontestuese që përfitimi nga ana e prokurorit po cilësohet i kundërligjshëm të paktën ato 5 mijë euro është fakt notor që i ka shfrytëzuar për qëllimin të cilin i ka marrë, po ashtu si rezultat i pendimit të tij që është shumë me rëndësi që gjykata të këtë parasysh duke pasur parasysh që kjo vepër penale është ndarë në subvencionin 1,2,3 ne kemi bërë marrëveshje me prokurorin dhe si rezultat i kësaj marrëveshje konsiderojmë se i kemi ndihmuar prokurorin që në çështjen e kësaj veprë penale apo të gjithë procesit në tërësi të zbulohen edhe persona të tjerë të cilët kanë qenë të përfshirë po flas për një marrëveshje për një rast tjetër që lidhet me subvencionet por që është rast i ndare. I

mbrojturi ka mbajtur 3 muaj paraburgim dhe 2 muaj arrest shtëpiak konsiderojmë që nëse qëllimi i dënimit është ndëshkimi dhe risocializimi për personat që ndeshen me ligjin, shkaktojnë pasoja tek i mbrojturi im ka arritur në tërësi qëllimin për të cilin ligji ka përcaktuar dhe çdo ndëshkim tjetër për neve konsiderojmë që nuk do të ketë efekt me shumë se sa që ka pasur efekt masa e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak dhe faturën financiare që është duke e paguar i njëjti për veprimet e tij. Andaj, konsiderojmë që gjykata gjatë matjes të këtë parasysh nenin 69 ndërsa sa i përket zbutjes së dënimit të ketë parasysh nenin 71 të KPRK-së, dhe pasi të shqiptojë dënimin çështjen e kompensimit pasurore juridike të udhëzohet në kontest civil kjo për faktin se edhe në deklarin e prokurorit në seancën e pranimit të fajësisë qartazi për rastin e H, prokurori tha se persona të tjerë dyshohen që nga shuma prej 14 mijë euro ti kenë marrë vlerën prej 9 mijë eurove, derisa do të përfundohet ai gjykim atje do të ishte vështirë të përcaktohet në këtë fazë dëmi potencial që do të mund të shkaktohej buxhetit të Kosovës nga ana e të mbrojturit tim.

I akuzuari H B, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se: e mbështes fjalën e mbrojtësit tim duke shtuar se burgun e kam përjetuar shumë rëndë në kohën e paraburgimit dhe me ka lanë pasoja shumë të mëdha dhe nëse caktohet diçka tillë për mua edhe një herë besoj që nuk mbes me për asgjë, nuk kam çfarë të shtoj tjetër.

#### 6. Gjendjet faktike të vërtetuara

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këto gjendje faktike:

- se i akuzuari Gj M, me dashje ka kryer veprat penale: Dhënia Ryshfetit në vazhdimësi nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale Mashtrimi me Subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohërat, vendet dhe mënyrat e përshkruar si në pikën I, II, III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

- se i akuzuari H B me dashje ka kryer veprat penale: Dhënia Ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së dhe Mashtrimi me Subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-se si në kohërat, vendet dhe mënyrat e përshkruar si në pikën IV, V të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### 7. Elementet e veprave penale

Në nenin 324 paragrafi 1 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Mashtrimi me subvencione e kryen: “Kushdo që në lidhje me aplikimin për marrjen, vazhdimin ose modifikimin e kushteve për marrjen e një subvencioni, i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta apo jo të plota, e që është kusht për aprovimin, vazhdimin apo modifikimin e subvencionit, ose fsheh të dhënat e tilla në kundërshtim me detyrimin për të zbuluar të dhënat e tilla organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”. Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni ka përcaktuar se: “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton në dobi pasurore ose në dëm pasuror që tejkalon shumën prej njëzetepesëmijë (25.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.

Ndërsa në nenin 422 paragrafi 2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Dhënia e Ryshfetit e kryen: *“Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për vete apo për një person tjetër i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.*

Ndërsa në nenin 424 paragrafi 2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Ushtrimi ndikimi e kryen: *“Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit tjetër, në mënyrë që ky person të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet”*

Në nenin 77 të KPRK-së, në paragrafin 1 është parashikuar dënimi për veprat penale në vazhdim, ku thuhet se: *“Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: 1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale; 1.2. objekti i njëjtë i veprës; 1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe 1.5. dashja e njëjtë e kryesit”.*

#### 8. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarit GJ M dhe H B, i ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën janë ngarkuar me akuzë ngase ka ardhur në përfundim se;

- në veprimet e të akuzuarit **GJ M** të përshkruara si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet e veprës penale Dhënia e Ryshfetit në vazhdimësi nga neni 422 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet e veprës penale Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.2 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet e veprës penale Mashtrimi me Subvencione nga neni 324 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së;

- ndërsa në veprimet e të akuzuarit **H B** të përshkruara si në dispozitivin IV të këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet e veprës penale Dhënia e Ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin V të këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet e veprës penale Mashtrimi me Subvencione nga neni 324 par.1 të KPRK-së.

### 9. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese;

#### **- Për të akuzuarin: Gj M:**

Si rrethana rënduese gjykata ka marr për bazë këto rrethana;

- Shkallën e Përgjegjësisë penale – që rezulton se i akuzuari kishte vepruar me dashje direkte andaj shkalla e përgjegjësisë penale e të akuzuarit është konsideruar si shkalla më e lartë e fajësisë, siç rezultojnë edhe nga rrethanat faktike por edhe nga provat e kësaj çështje penale se qëllimi kryesor i të akuzuarit ishte përfitimi i dobisë pasurore, ashtu që me përmendim përmes aplikimit me të dhëna të pasakta, kishte aplikuar për përfitimin e subvencioneve dhe për të përfituar këtë kishte dhënë edhe ryshfet për zyrtarët publik të përcaktuar si në dispozitiv.

- Faktin se i akuzuari Gj M veprën penale dhënie e ryshfetit dhe të mashtrimit me subvencione e kishte kryer në vazhdimësi, pra kishte vepruar në periudha të ndryshme kohore me qëllim të realizimit të dobisë pasurore për vete ashtu kishte dhënë në 6 raste ryshfet për zyrtarët publik dhe në 3 raste tjera kishte bërë mashtrime me subvencione.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana;

- rrethanat personale të akuzuarit se është baba i katër fëmijëve. Pra, mos prania dhe mos kujdesi i të akuzuarit për fëmijët e tij për një periudhë me të gjatë të dënimit me burgim, vetëm se do ta rëndonte gjendjen e tyre;

- bashkëpunimi dhe sjellja e tij tejet korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku i njëjti edhe nga në këtë rast është shpallur nga PSRK si dëshmitar bashkëpunues.

- pendimin i tij thellë i shprehur në seancat e mbajtura për veprat penal të kryera;

- Faktin se i akuzuari Gj M, nuk ka rënë ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët kanë kryer ndonjë vepër penal.

- Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilën për cilat ishte ngarkuar me aktakuzë dhe tani sipas këtij aktgjykimi është shpallur fajtor, të cilin pranim të fajësisë e kishte bërë edhe në fazat e mëhershme të procedurës.

**- Për të akuzuarin H B;**

Si rrethana rënduese gjykata ka marr për bazë këto rrethana;

- Shkallën e Përgjegjësisë penale – që rezulton se i akuzuari kishte vepruar me dashje direkte andaj shkalla e përgjegjësisë penale e të akuzuarit është konsideruar si shkalla më e lartë e fajësisë, siç rezultojnë edhe nga rrethanat faktike por edhe nga provat e kësaj çështje penale se qëllimi kryesor i të akuzuarit ishte përfitimi i dobisë pasurore, ashtu që me përmendim përmes aplikimit me të dhëna të pasakta, kishte aplikuar për përfitimin e subvencioneve dhe për të përfituar këtë kishte dhënë edhe ryshfet për zyrtarët publik të përcaktuar si në dispozitiv.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana;

- Rrethanat personale të akuzuarit se është baba i katër fëmijëve. Pra, mos prania dhe mos kujdesi i të akuzuarit për fëmijët e tij për një periudhë me të gjatë të dënimit me burgim, vetëm se do ta rëndonte gjendjen e tyre;

- Bashkëpunimi dhe sjellja e tij tejet korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore.

- Pendimin i tij thellë i shprehur në seancat e mbajtura për veprat penal të kryera;

- Faktin se i akuzuari H B, nuk ka rënë ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët kanë kryer ndonjë vepër penal.

- Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilën për cilat ishte ngarkuar me aktakuzë dhe tani sipas këtij aktgjykimi është shpallur fajtor, të cilin pranim të fajësisë e kishte bërë edhe në fazat e mëhershme të procedurës.

Kështu që duke marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe se dënimet unike të shqiptuar me dënim me burgim dhe dënim gjobë sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, ka shqyrtuar dhe analizuar edhe rekomandimet nga raportet para ndëshkuese e Shërbimeve Sprovuese të Drejtorisë Rajonale në Pejë dhe Ferizaj që të akuzuarve të i shqiptohet dënim alternativ pra dënim me kusht apo punë në dobi të përgjithshme, mirëpo duke marrë për bazë rrethanat e lartpërmendura rënduese dhe lehtësuese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit dhe se me



dënimet e rekomanduara nga Shërbimet sprovuese nuk do të ishin si preventivë për parandalimin e të tjerëve që të kryenin vepra të njëjta apo të ngjashme, këtë duke marrë për bazë rrethanat dhe mënyrat se si janë kryer veprat penale ku janë keqpërdorur subvencionet të cilat janë një ndihmë që shteti i jep një dege të ekonomisë, një institucioni etj, për të mbështetur veprimtarinë e qytetarëve, prandaj me dënime të rekomanduara të njëjtat do të kishte një efekt negativ tek të tjerët për të parandaluar nga kryerja e veprave penale siç parasheh si kusht edhe tek nenit 38 i KPRK-së.

#### 10. Vendimi lidhur me llogaritjen e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak

Gjykata konform nenit 79 të KPRK-së, kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak të akuzuarve iu është llogaritur në dënimet e shqiptuara me burgim si në dispozitivë të këtij aktgjykimi.

#### 11. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 451 par.1 dhe nenin 453 të KPP-së, si dhe duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata ka vendosur që e akuzuara t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 12. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Duke u bazuar në nenin 457 par.1 të KPP-së gjykata ka vendosur që e dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, të udhëzohet për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për pjesën gjyqësore konform nenit 364 par.1 dhe 2 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**- DEPARTAMENTI SPECIAL -**  
**PS.nr.20/24, me datë 13.03.2024**

**Bashkëpunëtori Profesional,**  
**Nazif Fetahu**

**Kryetari i trupit gjyqësor,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë – Departamenti Special, nëpërmjet kësaj Gjykate.